



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11 shtator 2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektrezolutës “Për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë”.
(Komision përgjegjës)

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave”. (Komision për dhënie mendimi)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Arben Pëllumbi dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Tom Doshi dhe Silva Caka.

Të ftuar:

Dorina Çinari – Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Erinda Ballanca – Avokate e Popullit

Enio Haxhimihali – Drejtor i Kabinetit të Avokates së Popullit

Robert Gajda – Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Aurela Bozo – drejtore ekzekutive e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare

Altin Hazizaj – drejtor ekzekutiv i CRCA-së

Vasilika Laci – drejtore ekzekutive e organizatës “Civil Rights Defender”

Agim Bregasi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Fatos Bundo – Drejtor në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare
Rolanda Hila – Specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Anisa Pine – Specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Aldo Xherahu – fotograf në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Tedi Bushaj – specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Ftohet media të jetë e pranishme.

(Diskutime në sallë)

Ulsi Manja – Ju lutem, kolegë, zini vendet! Të ftuarit të zënë vendet!

Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Në rendin e ditës kemi dy çështje: shqyrtimin e projektrezolutës për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë”, që është nismë e deputetes Vasilika Hysi, dhe komisioni ynë është komision përgjegjës, ndërsa si pikë të dytë të rendit të ditës kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave”, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi. Relator do të jetë kolegu Bledar Çuçi.

Përpara se të fillojmë me rendin e ditës, më lejoni që në emër të kolegëve të mi të komisionit, edhe pse në mungesë, t’i urojmë 45-vjetorin nënkryetarit të Komisionit të Ligjeve, zotit Alibeaj: edhe 100!

Në fakt, do të kishim dëshirën që kolegët të ishin sot të pranishëm këtu, por, gjithsesi, urimi vlen edhe në mungesë.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, me projektrezolutën.

U kërkoj ndjesë organizatave të shoqërisë civile dhe të institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, të cilat janë ftuar për të qenë pjesë e këtij diskutimi, për kohën shumë të shkurtër në dispozicion në lidhje me njoftimin, por meqenëse dje kishim mbledhjen e parë të Komisionit të Ligjeve dhe kjo projektrezolutë është në kalendarin e ditës së enjte të punimeve të Kuvendit, kjo ishte koha që kishim në dispozicion. Por gjithsesi jemi të hapur gjatë diskutimit të kësaj projektrezolute edhe për sugjerimet dhe opinionet e përfaqësuesve të institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile, në funksion të pasurimit të kësaj rezolute, pse jo edhe të përmirësimit të këtij drafti.

Pa humbur kohë, po ia jap fjalën propozueses së kësaj rezolute, koleges Vasilika Hysi, për të vijuar më pas me relatoren, zonjën Xhina.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni të prezantoj të ftuarit.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen dhe janë të pranishëm nga institucioni i Avokatit të Popullit: zonja Erinda Ballanca, Avokate e Popullit, dhe zoti Enio Haxhimihali, drejtor i kabinetit; zoti Robert Gajda, komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi; zonja Aurela Bozo, drejtoreshë ekzekutive e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare; zoti Altin Hazizaj, drejtor i Qendrës për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri, si dhe zonja Vasilika Laci, drejtoreshë ekzekutive e organizatës “Civil Rights’ Defender”. Besoj se janë prezentë në sallë.

Duke ju falënderoj për prezencën tuaj sot në komision, po ia kaloj fjalën koleges Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

E nderuar zonja Avokate e Popullit,

I nderuar zoti Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

Të nderuar përfaqësues të shoqërisë civile,

Në fakt, kjo projektrezolutë është firmosur nga unë, por është produkt i punës së bërë nga një grup i madh kontribuuesish në parlament dhe jashtë tij. Ajo është një iniciativë, që e ka zanafillën e saj në një forum që organizoi Kuvendi i Shqipërisë më 13 prill 2018, në Forumin për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, që është një iniciativë që u organizua me mbështetjen e Këshillit të Europës dhe të Komisionit Europian, bazuar në iniciativën e ish-Avokatit të Popullit, zotit Igli Totozani, ku të gjithë ju keni qenë të pranishëm dhe keni kontribuar.

Pse kjo iniciativë? Forumi u mbajt në kuadër të 20-vjetorit të miratimit të deklaratës së OKB-së për mbrojtësin e të drejtave të njeriut, e cila njih përgjegjësitë që kanë shtetet dhe qeveritë për të krijuar një mjedis sa më të përshtatshëm për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, të cilët mund të jenë individë, organizata, ose grupe shoqërore.

Bashkimi Europian ka miratuar një udhëzues europian në vitin 2004 për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut.

Këshilli i Europës ka përparuar më tej dhe ka evoluar, duke u kërkuar shteteve anëtare të KE-së, përfshirë këtu edhe Shqipërinë, nëpërmjet rekomandimit të vitit 2018 për të hartuar një strategji për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vendet anëtare të KE-së.

Po ashtu, edhe OSBE/ODIHR-i ka një kontribut të ndjeshëm në krijimin e një ambienti të përshtatshëm.

Të mos harrojmë shumë individë, grupe shoqërore, organizata dhe institucione të pavarura kushtetuese apo të krijuara me ligj në Shqipëri e kanë ngritur shpesh zërin dhe kanë adresuar një sërë shqetësimesh, që lidhen me mjedisin në të cilin operojnë mbrojtësit e të drejtave të njeriut, me nevojën e forcimit të rolit të tyre, si dhe me rolin shumë të rëndësishëm që ata kanë në shoqëritë demokratike.

Në këtë kuadër lind natyrshëm një pyetje: Pse duhet të hartojë Kuvendi një rezolutë të tillë? Arsyet kryesore janë 3.

E para, është se mbrojtësit e të drejtave të njeriut, qofshin individë, grupe shoqërore apo organizata janë një element shumë i rëndësishëm në forcimin e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës.

E dyta, jo vetëm në regjimet jodemokratike, por edhe në regjimet demokratike mbrojtësit e të drejtave të njeriut hasin një sërë pengesash dhe vështirësish. Në shumë vende është vënë në rrezik jeta e tyre. Këtu nuk kam parasysh vetëm gazetaret investigativë, por edhe një sërë veprimtarësh të tjerë, mbrojtës të të drejtave të njeriut, të cilët janë të angazhuar në mbrojtjen e kategorive të posaçme në shoqëritë tona.

Pse Kuvendi? Është pikërisht një detyrim që kanë ligjbërësit në të gjitha vendet për të krijuar një mjedis miqësor jo vetëm nëpërmjet përmirësimit të strukturës ligjore, pra ushtrimit të funksionit ligjvënës, por edhe nëpërmjet asaj që është shtylla e dytë e veprimtarisë së çdo parlamenti, veprimtarisë së mbikëqyrjes parlamentare.

Të mos harrojmë se në bazë të Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit, në rastin e Shqipërisë, kemi një sërë institucionesh që janë mbrojtëse të të drejtave të njeriut, të cilat raportojnë në Kuvend dhe Kuvendi ka përgjegjësinë dhe detyrimin për t'u krijuar të gjitha kushtet që ato të jo vetëm të funksionojnë të pavarura, por edhe për t'i fuqizuar ekonomikisht, financiarisht dhe nga pikëpamja e burimeve njerëzore. Të mos harrojmë që edhe media investigative në Shqipëri ka marrë një zhvillim të kënaqshëm në vitet e fundit.

Siç e thashë edhe në fillim, kjo projektrezolutë është iniciuar në këtë forum. Drafti i parë i saj është përgatitur nga ish- Avokati i Popullit, zoti Igli Totozani, në bashkëpunim me ekspertët më të mirë të OKB-së e të BE-së. Ajo është konsultuar edhe me Këshillin e Europës. Një kontribut të veçantë kanë dhënë deputetët tanë, që janë pjesë e delegacionit në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Europës, në mënyrë të veçantë, deputetja Bushka.

Për hartimin e kësaj projektrezolutive kemi mbajtur në konsideratë një sërë dokumentesh, duke filluar nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, që ka 70-vjetorin sivjet dhe një sërë dokumentesh të fundit, duke pasur parasysh edhe rezolutën e vitit 2018 dhe rekomandimin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vendet anëtare të KE-së.

Çfarë parashikon në thelb projektrezoluta?

Është një Nënkomision për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë. Ai është pjesë e këtij komisioni të nderuar, i cili do të shërbejë si një mekanizëm dialogu mes Kuvendit të Shqipërisë dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut, në bashkëpunim me këtë komision të nderuar, por edhe me mekanizmin ndërinstitucional që ka ngritur Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 47/2017 për të zbatuar dhe për të pasur një plan veprimi për të promovuar dhe për të mbështetur mbrojtësit e të drejtave të njeriut, gjë që kërkon që në mënyrë sistematike të vlerësohet situata e mbrojtësve të të drejtave të njeriut duke pasur një raport në Kuvendin e Shqipërisë, por mbi të gjitha, është rishikimi, nëse është e nevojshme, i legjislacionit në këtë fushë. Ka një sërë problematikash që organizatat e shoqërisë civile dhe mbrojtësit i kanë adresuar. Të mos harrojmë se Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar edhe një rezolutë për mbështetjen e shoqërisë civile disa vite më parë. Në këtë kuadër, jemi edhe në frymën e kësaj rezolutive të miratuar që më parë.

E dyta, është forcimi i mekanizmit të kontrollit parlamentar të parashikuar në Rregulloren e Kuvendit. Në këtë mënyrë Komisioni i Ligjeve merr një rol edhe më aktiv në kuadër të mekanizmit ndërinstitucional për të ndjekur një për një të gjitha rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, organizatave të shoqërisë civile, të grave, të fëmijëve, të minoriteteve etj.

Të mos harrojmë se një element shumë i rëndësishëm është edhe lufta kundër korrupsionit. Ne kemi struktura edhe në shoqërinë civile, edhe në qeveri, të cilat janë të fokusuar në luftën kundër korrupsionit të kryer nga zyrtarët publikë ose funksionarët shtetërorë, që shpesh për shkak të denoncimeve, që mund të bëhen nga media ose nga gazetarët, mund të ketë probleme lidhur me mbrojtësit e të drejtave të njeriut. Në këtë kuadër ka një sërë kërkesash që i adresohen qeverisë, KM-së, lidhur me forcimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe me institucionet e pavarura, në mënyrë që të paktën të organizohet një takim në vit, ku të bëhet një analizë e situatës së mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe të merren në konsideratë të gjitha rekomandimet e bëra.

Gjithashtu, i kërkohet KM-së të krijojë një strukturë për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të favorshëm për aktivitetin e mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe të paraqesë një raport vjetor në Komisionin e Ligjeve lidhur me situatën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Në fakt, ky nuk është një element që ne nuk e kemi të parashikuar tashmë, sepse ky është parashikuar edhe në vendimin që ka miratuar Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2017, në kuadër të mekanizmit ndërinstitucional, ku Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë do të raportojë në fund të vitit, para se Avokati i Popullit të sjellë raportin vjetor, për të parë se çfarë ka bërë qeveria, çfarë ka bërë Kuvendi lidhur me rekomandimet, që ka paraqitur në raportin vjetor ose në raportet specifike Zyra e Avokatit të Popullit apo Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe një sërë drejtorish të tjera dhe në mënyrë të veçantë, shoqëria civile. Kjo kërkon që Kuvendi të forcojë në këtë kuadër bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe kjo e fundit të informojë dhe të paraqesë shqetësimet që ka në komisionet përkatëse.

Gjithashtu, i kërkohet Këshillit të Ministrave, që në konsultim me institucionet e pavarura, me organizatat ndërkombëtare dhe me ato të shoqërisë civile...

Ulsi Manja – Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Po, patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju keni shumë të drejtë. Po i bie shkurt. Po e përmbledh.

Një pikë e veçantë është vënë edhe për DAP-in, për të programuar formimin vazhdues të punonjësve të administratës publike, që shpesh nuk kanë sensibilitetin për të drejtën e informimit, për informacionin dhe për ofrimin e shërbimeve për kategori të veçanta. Ka kërkesa të posaçme për Ministrinë e Arsimit dhe për Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme për të forcuar veprimtarinë në këtë fushë.

Të nderuar kolegë, mbrojtja e mbrojtësve të të drejtave të njeriut nuk mund të bëhet vetëm nëpërmjet ligjeve të hartuara mirë apo kontrollit parlamentar, rëndësi ka sistemi i drejtësisë. Padyshim që ne nuk mund të ndikojmë te drejtësia, por ne inkurajojmë organet e drejtësisë të rrisin aksesin e mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Kjo është në vazhden e ligjeve që kemi miratuar për ndihmën e garantuar nga shteti. Me këtë rast dua të falenderoj të gjithë përfaqësuesit e institucioneve kushtetuese; Komisionerin, Avokatin e Popullit dhe shoqërinë civile për kontributin që dhanë në hartimin e këtij ligji, i cili ka futur mbrojtësit e të drejtave të njeriut si kategori që përfitojnë falas në rastet kur ata janë viktimat të diskriminimit ose abuzimit

me të drejtat e njeriut, por njëkohësisht është edhe angazhimi që ka marrë Kuvendi për të forcuar institucionet e pavarura.

Kjo ishte një përmbledhje shumë e shkurtër e kësaj projektrezolutive. Falenderoj të gjithë kolegët që kanë kontribuar, kryetarin e komisionit për mbështetjen që i ka dhënë rezolutës së bashku me Kryetarin e Kuvendit dhe Kryetarin e Grupit Parlamentar, megjithëse ishte periudha e mbylljes së sesionit, por edhe të gjithë kolegët e tjerë, të cilët janë përpjekur të përmirësojnë paragrafë të veçantë.

Sikurse e tha edhe Kryetari i Kuvendit, jemi të gatshëm të mirëpresim çdo mendim dhe sugjerim që mund të ketë Avokati i Popullit, Komisioneri për Parandalimin e Diskriminimit, përfaqësuesit, zonja Laçi apo zonja Bozo, por edhe përfaqësuesit e medias.

Ju kërkojmë ndjesë për njoftimin e shkurtër, por donim që këtë sesion plenar dhe këtë mbledhje të parë të komisionit, pas miratimit të kalendarit, ta nisim me këtë projektrezolutë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi për nismën dhe relatimin tuaj sot para kolegëve të Komisionit!

Fjalën e ka relatorja, Elena Xhina. Ju lutem prezantoni shkurt gjetjet e kësaj projektrezolutive.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Falenderoj përfaqësuesit e institucioneve të pavarura, që janë sot këtu dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile! Gjithashtu, gjej rastin të përgëzoj edhe nismëtare e kësaj projektrezolutive së bashku me gjithë mbështetësit që kanë punuar me të për kontributin që japin me anë të kësaj rezolutive në fushën e të drejtave të njeriut.

Garantimi dhe respektimi i të drejtave të njeriut përbën një nga prioritetet e vendit tonë për integrimin në Bashkimin Europian. Nga ana tjetër, këto garanci për respektimin e të drejtave të njeriut përbëjnë një nga shtyllat themelore të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pasuar kjo edhe me kuadrin ligjor që parashikojnë ligjet specifike në këtë fushë.

Kjo projektrezolutë do t'i vijë në ndihmë akoma më tepër këtij kuadri ligjor, pasi qëllimi kryesor i saj është t'i japë garanci dhe mbrojtje mbrojtësve të të drejtave të individëve, organizatave apo grupeve shoqërore që luftojnë për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kjo përbën zhvillim dhe risi në kuadrin ligjor shqiptar. Kjo projektrezolutë vendos qëllime dhe synime të larta për të vendosur një urë lidhëse midis Kuvendit dhe këtyre institucioneve apo shoqërisë civile, e cila merret me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Nuk dua të ndalem më tepër te qëllimet, piketat apo detyrimet që kjo projektrezolutë u vë institucioneve dhe Kuvendit, pasi ato u parashtruan nga nismëtarja, por duke e parë si një risi në këtë drejtim dhe duke vlerësuar se kjo projektrezolutë do të shërbejë në mbështetjen dhe njohjen e veprimtarisë së të drejtave të njeriut, të personave që e mbrojnë dhe e çojnë përpara atë në mënyrë që të nxisin, promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të forcojnë shtetin e së drejtës dhe të konsolidojnë demokracinë e vendit tonë, i ftoj anëtarët e komisionit që ta votojmë këtë projektrezolutë dhe më pas të propozojmë miratimin e saj edhe në seancë plenare.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Dëshirojnë të shprehen për projektrezolutën përfaqësuesit e tjerë apo Avokatja e Popullit?

Fjala është për ju, zonja Ballanca.

Erinda Ballanca – Faleminderit, zoti kryetar!

Ju falënderojmë të gjithëve që, në vijim të seriozitetit që këtë komision e karakterizon, e nisni këtë sesion me një çështje shumë të rëndësishme, siç është ajo e mbrojtësve të të drejtave të njeriut.

Një nga rolet e tij kushtetues dhe ligjor Avokati i Popullit ka pikërisht promovimin e të drejtave të njeriut. Në kuadër të promovimit të të drejtave të njeriut, roli që të gjitha organizatat e shoqërisë civile dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut kanë në të gjithë këtë panoramë të problematikave që mund të ketë Shqipëria apo edhe vende të tjera, në mënyrë të veçantë duke adresuar të drejtat e njeriut është shumë i rëndësishëm.

Thënë kjo, duke mbështetur fuqimisht rezolutën, ashtu siç edhe në parim dhe siç u parashtrua nga e nderuara zonja Hysi në relacionin që ajo paraqiti, mendoj se ne do të na duhet pak më tepër kohë. Fatkeqësisht, ne e kemi marrë materialin dje në orën 16:00 dhe e kemi pasur të pamundur që ta konsultojmë në institucion me komisionerët apo kolegët.

Ne mund të themi 2-3 pika që mund të përmirësohen, por mendoj se kjo është një çështje shumë e rëndësishme, për të cilën ne do të na duhet pak më shumë kohë për të dhënë një mendim të pjekur dhe për të parë edhe 2-3 vende të tjera si e kanë organizuar. Ndoshta ky që është zgjedhur është mekanizmi perfekt, nuk dua ta paragjykoj, por do të donim që puna jonë dhe mendimi ynë të vinte pas një diskutimi edhe brendapërbrenda institucionit. Kjo sepse, ndër të tjera, siç e thashë, një pjesë e këtyre çështjeve janë pjesë e aktivitetit që ne kemi dhe detyrave tona kushtetuese. Prandaj, që të mos kemi mbivendosje fryma duhet të jetë e nivelit

që të jenë dy mekanizma për të bërë më shumë. Që të kemi një lloj energjie të re dhe sinergjie për ta çuar çështjen përpara, do të duhet që ne t'i adresojmë disa çështje në mënyrë pak më të detajuar.

Unë ju kërkoj që, nëse është e mundur, të na jepni pak më shumë kohë për të dhënë një mendim profesional në lidhje me këtë çështje.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Ballanca!

Po, zoti Gajda!

Robert Gajda - Përshëndetje të gjithëve!

Pa diskutim që projektrezoluta që propozohet është e kurueshme dhe shumë mirë që Kuvendi merr nisma të tilla. Patjetër që është kthyer në një organ lider, sidomos në njohjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, kjo edhe në vazhden e takimit që kemi pasur dikur duke ekspozuar dhe evidentuar problematikat në një tryezë më të gjerë me organizatat e shoqërisë civile ku u ekspozuan të gjitha problematikat që i shoqërojnë dhe i ndjekin gjatë aktivitetit të tyre.

Faktikisht, edhe zyra e komisionerit mendon që, nëse do të duam të japim një mendim më të pjekur dhe reflektues, është e nevojshme një marrje kohe jo shumë e gjatë. Rezoluta nuk është jashtëzakonisht e madhe, por, gjithsesi, për të dhënë një mendim dhe për të evidentuar disa pika në funksion të përmirësimit të produktit që Kuvendi do që të miratojë dhe për të pasur një rezolutë sa më të plotë dhe që të reflektojë sa më mirë problematikat dhe zgjidhjen e tyre, është e nevojshme të merret pak kohë (mund ta vendosim bashkarisht) në mënyrë që të sjellim mendimet me shkrim në adresën tuaj, si dhe që të shikojmë nëse jemi në rrugën e duhur apo do të duhet të përmirësojmë diçka.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Ju lutem, prezantohuni.

Vasilika Laçi – Përshëndetje!

Unë quhem Vasilika Laçi dhe punoj për një organizatë suedeze që quhet *Civil Rights Defender*, e cila mbështet mbrojtësit e të drejtave të njeriut. Vërtetë duam t'ju përgëzojmë dhe falenderojmë zonjën Hysi që e solli këtë rezolutë në Kuvend, zotin Totozani, i cili e prezantoi fillimisht dhe ka qenë, si të thuash, nismëtar dhe të gjithë kolegët që kanë kontribuar për këtë rezolutë! Ne e shikojmë vërtetë të rëndësishme këtë rezolutë edhe për shkak të natyrës së demokracisë shqiptare dhe të mënyrës se si qytetarët kanë nevojë të ndihmohen dhe të fuqizojnë rolin e tyre si qytetarë aktivë në shoqërinë shqiptare, sidomos ata persona që kanë një rol të veçantë dhe për arsye të profesionit të tyre ose për arsye të vokacionit të tyre të brendshëm

zgjedhin ta ngrenë zërin në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Kush preket nga kjo rezolutë dhe pse është ajo e rëndësishme?!

Nga kjo rezolutë preken persona që janë formalisht të përfshirë në shoqërinë civile, persona që nuk janë të përfshirë në shoqërinë civile, por janë aktiviste, për shembull, aktivistët në mbrojtje të teatrit ose persona të tjerë, siç janë gazetarët. Pra, është e nevojshme që në një shoqëri si Shqipëria t'u jepen mesazhe të forta qytetarëve dhe aktivistëve të të drejtave të njeriut që ata janë të mbrojtur, që kanë një zë kujt t'i drejtohen dhe që të kenë mekanizma ku ata të ngrenë zërin për shqetësimet e tyre. Mendoj se kjo rezolutë krijon një taban të rëndësishëm për t'i dërguar këto mesazhe, të cilët janë më shumë mesazhe moralo-politike se një lloj mekanizmi ligjor, sepse mekanizmat ligjorë për të drejtat e njeriut, tashmë, ekzistojnë në Shqipëri dhe disa përfaqësues të tyre janë të pranishëm në sallë. Unë bashkohem me sugjerimin e kolegëve që të marrim më shumë kohë që t'ju sjellim sugjerime me shkrim, ndoshta të shtojmë edhe disa mekanizma apo elemente konkrete për ta bërë sa më konkrete këtë rezolutë. Gjithashtu, ju ftoj ta ndani edhe me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, të cilët do të donin të ishin pjesë e kësaj rezolute dhe të kishin zërin e tyre, sidomos ata persona dhe grupe të cilat ju i keni cituar në rezolutë që cenohen nga puna e tyre, si personat që luftojnë korrupsionin, personat e grupeve LGBT, gazetarët e kështu me radhë.

Disa aspekte të tjera të rëndësishme, të cilat do të jenë një forum diskutimi që do të lejohet nga kjo rezolutë, janë aspektet e tjera të funksionimit të shoqërisë civile. Për shembull, nevoja për të ndryshuar ligjin e shoqërisë civile që ka shumë vjet i pandryshuar, sidomos regjistrimi. Pse duhet një shoqatë e krijuar në Valbonë për të mbrojtur lumin nga ndërtimi i një hidrocentrali të vijë në Tiranë për t'u regjistruar apo për të ndryshuar çdo aspekt të vogël të regjistrimit të zyrës? Këto gjëra e pengojnë punën e shoqërisë civile ose e ngadalësojnë atë.

Gjithashtu, edhe liria e shprehjes është shumë e rëndësishme në kuadër të të drejtave të njeriut. Një çështje tjetër shumë e rëndësishme është liria e tubimit. Edhe ky ligj ka nevojë të rishikohet. Tashmë që puna e nënkomisionit dhe komisionit rifilloi do t'ju sjellim propozimet tona konkrete në lidhje me këtë ligj për t'iu përshtatur më mirë standardeve ndërkombëtare, sidomos standardeve të ODIHR-it.

Edhe një herë, ju përgëzoj! Shpresoj që procesi të vazhdojë me shpejtësi, siç thanë edhe kolegët, si dhe të keni parasysh edhe komentet tona e të kolegëve të tjerë që nuk kanë pasur mundësi ta shfletojnë deri tani këtë rezolutë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ju lutem prezantohuni, zonjë!

Aurela Bozdo – Quhem Aurela Bozdo nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare. E vlerësojmë këtë iniciativë dhe e shohim shumë të rëndësishme, sepse mendoj se hapi i parë është njohja e rolit mbrojtës të të drejtave të njeriut, më pas garantimi i të drejtave dhe mbrojtja e tyre.

Së pari, dua të ndaj me ju faktin që Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, si shumë organizata të tjera në vendin tonë, punon për mbrojtjen e të drejtave të grave. Në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, do të doja të theksoja dhe të përgëzoja punën e bërë, për shkak se në draftrezolutën e përgatitur ka një vëmendje të veçantë ndaj grupeve vulnerable, duke përfshirë edhe grupet e grave. Ajo që dua të ndaj është fakti se nga leximi i parë që i kam bërë draftrezolutës, kam konstatuar se është një draftrezolutë në përqasje me aktet ndërkombëtare, në përqasje me rezolutën e fundit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës dhe e vlerësoj shumë këtë. Qendra jonë, si edhe shumë qendra të tjera që punojnë në këtë fushë, punon për mbrojtjen e grave, viktimave të formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore, si viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, viktimave të dhunës në familje. Të gjithë mund ta kuptojnë se me çfarë formash specifike përballen avokatët e mbrojtjes së të drejtave të grave, të një viktime trafikimi, kur, për shembull, kërkojnë dëmshpërblim për një viktimitë trafikimi apo për një viktimitë të dhunës në familje që ka humbur jetën. Dua të them se, pavarësisht vlerësimit që kam për vëmendjen e veçantë, këto grupe vulnerable, duke përfshirë edhe grupet e marginalizuara të grave, mendoj se mund të kenë edhe më shumë vëmendje në lidhje me format specifike, me të cilat përballen *Human Rights Defenders* dhe, pasi të njihen këto forma specifike me të cilat ata përballen, edhe mekanizmat specifike në mbrojtje të tyre mund të jenë më të përshtatur.

Dua të ndaj me ju edhe faktin që ne planet e qendrës sonë, në bashkëpunim me qendra të tjera, ne kemi parashikuar të ngremë edhe një rrjet për mbrojtjen e të drejtave të grave. Ju e dini që raporti special i mbrojtjes së të drejtave të njeriut ka paraqitur një pyetësor nga vendet anëtare të Këshillit të Europës, që të plotësohet me të dhënat se si është situata e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe mbrojtësit e të drejtave të grave në vendet e ndryshme. Më vjen mirë që në plotësimin që do t'i bëjmë këtij pyetësori, i cili ka *deadline* datën 28 shtator, ne do të mund të ndajmë përveç situatës faktike edhe këtë hap kaq të rëndësishëm që merr ky komision dhe nënkomisioni për të drejtat e njeriut. I bashkohem mendimit të parafolësve për të paraqitur më shumë komente dhe sugjerime me shkrim brenda afatit që ju do të përcaktoni.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Urdhëroni!

Vasilika Laçi – Faleminderit!

E kisha përgatitur që në fillim, por nuk e kisha shënuar te pikat dhe e harrova. Ajo që ndodhi me gazetaren Klodiana Lala, e cila u kërcënua me jetën e saj dhe me atë të familjarëve, është një sinjal alarmi për t'u treguar edhe autoriteteve, Kuvendit dhe të gjitha institucioneve se është shumë e rëndësishme ta ngremë të gjithë zërin në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Siç e thashë, gazetarët janë një nga grupet më të rëndësishme në këtë aspekt dhe kanë nevojë për një mbrojtje të veçantë si në mbrojtjen individual në raste të tilla, ashtu edhe në frymën e përgjithshme që përçojnë institucionet apo politikanët, të cilët duhet t'i respektojnë këta aktorë si individë të rëndësishëm në shoqëri dhe jo t'i etiketojnë me emra të caktuar që nuk po i përmend këtu, sepse të gjithë e dini se për çfarë bëhet fjalë.

Ju falënderoj edhe një herë dhe punë të mbarë!

Ulsi Manja – Faleminderit!

A ka pyetje?

Fjalën e ka zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj të pranishmit!

Mbrojtja e të drejtave të njeriut nuk ka klasifikim dhe është njëlloj për të gjithë, duke filluar nga Presidenti i Republikës deri te qytetari më i thjeshtë. Të mbrosh të drejtat e njeriut është e domosdoshme për këdo. Natyrisht, individë të caktuar mund të kenë akses të jashtëzakonshëm në jetën shoqërore dhe mbase kanë edhe mundësi për të folur më shumë, kanë mundësi edhe për të përfituar edhe më shumë. Ndërkohë, ai fermeri im në Lushnjë apo një qytetar tjetër në Tiranë, në Tropojë nuk mund ta ketë këtë mundësi dhe ne duhet të kujdesemi për ta.

Falënderoj në mënyrë të veçantë zonjë Hysi dhe Nënkomisionin e të Drejtave të Njeriut për projektrezolutën, Avokatin e Popullit, Komisionerin dhe të pranishmit për mendimet dhe sugjerimet dhe për kohën më tepër që kërkuan për këtë projektrezolutë! Gjithsesi, nuk duhet të harrojmë se është projektrezolutë dhe, sado kohë që ju të merrni (dhe jam plotësisht dakord për një dy apo tri ditë, por e cakton kryetari i komisionit), në fund të fundit ky draft është përgatitur me kujdes dhe me seriozitet. Cila është vërejtja që kam unë, e cila mbase edhe ju do t'ju ndihmojë për të dhënë një mendim në funksion të asaj që duam të arrijmë për një projektrezolutë! Projektrezoluta, në fakt, është në kuadër e një deklarimi, pra ne deklarojmë një, dy, tre, katër apo pesë. Mua më pëlqen një projektrezolutë e realizuar, nuk më pëlqen një projektrezolutë e deklaruar. Një projektrezolutë që deklarohet, kalon me unanimitet në

parlament dhe do të duhet të kalohet nga të gjitha forcat politike, sepse është e mangët në qoftë se ato, që janë thënë atje brenda, nuk realizohen me një plan veprimi. Çfarë dua të them me këtë, zonja Hysi (e kam edhe për ju, por edhe për Avokatin e Popullit dhe për Komisionerin)? Në qoftë se ne themi se duam të kemi një plan veprimi të promovimit, të mbështetjes së të drejtave të njeriut në Republikën e Shqipërisë, atëherë mos ka ardhur koha që ne në projektrezolutë të vëmë disa afate konkrete. Për shembull, në disa pika ju thoni t'i kërkojmë Këshillit të Ministrave bashkëpunimin dhe konsultimin me shoqëritë civile dhe institucionet e pavarura për të bërë një strategji dhe plan veprimi. Kur do të bëhet kjo?! Po ta bëjmë deklarative kërkesën, ia kërkojmë dhe mund të vijmë prapë pas 20 vjetësh dhe ne ende nuk e kemi bërë këtë plan veprimi. Në qoftë se ne do t'i kërkojmë qeverisë dhe shoqërisë civile të ribëjmë një ligj të ri për shoqërinë civile, duhet ta saktësojmë se kur kjo bëhet efektive. Për shembull, nëse kjo bëhet efektive 6-mujorin e parë të vitit 2019, duhet të shënohet në këtë projektrezolutë.

Zonja Hysi, i them këto në mënyrë që kësaj projektrezolute t'i vihen afate konkrete. Edhe ju si Nënkomision i të Drejtave të Njeriut keni të drejtë, pasi të miratohet dhe pasi të ketë afate konkrete, të verifikoni në terren, ta shikoni dhe të na bindni, sipas pikës dy, se çfarë u bë, si u bë dhe si u realizua. Kjo është më e rëndësishme sesa këto pikat e tjera.

Na pëlqen t'i kërkojmë qeverisë të promovojmë nisma, të zbatojmë mekanizma, të organizojmë një herë në vit, t'i kërkojmë Këshillit të Ministrave, strukturave e kështu me radhë, por kur vjen puna te prokuroria, themi: "Të ftojme organin e prokurorisë dhe të gjyqësorit". Jo, nuk duhet të themi "T'i kërkojmë", dhe këtu po e ngre zërin, jemi republikë parlamentare, nga ne burojnë të gjitha pushtetet. Çfarë po u kërkojmë prokurorisë dhe gjyqësorit te pika 17? Pse po e përkëdhelim duke i thënë: "T'i ftojme"? Jo, duhet t'u kërkojmë prokurorisë dhe sistemit gjyqësor, në mënyrë që mbrojtja e të drejtave të njeriut të gëzojë akses në sistemin e drejtësisë, të mundësojnë hetime të shpejta dhe të plota për rastet e dhunës, kërcënimet dhe ngacmimet ndaj mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Në qoftë se ne kërkojmë një gjë të tillë, kërkojmë të bëjmë detyrën. Pse duhet të themi: "E ftojme"? Sepse ai mund të thotë që me këtë rezolutë më ka ftuar dhe mund të bëjë ose jo. Jo, ne duhet ta kërkojmë me afate konkrete, ashtu siç ia kërkojmë qeverisë, siç ia kërkojmë shoqërisë civile, siç ia kërkojmë Avokatit të Popullit dhe siç ia kërkojmë komisionerit.

I thashë të gjitha këto, në mënyrë që ta korrigjojmë dhe ta mendojmë, meqenëse duhen edhe 2-3 ditë kohë që institucionet të japin ndonjë mendim më konkret.

Unë e thashë edhe dje në mbledhjen e grupit që kjo rezolutë të marrë vlerë duhet të bëhet me gjëra jodeklarative, por më shumë e realizuar, në mënyrë që ne të ndjehemi mirë që

e bëme një rezolutë të tillë dhe të mos ngelet në kuadrin e shumë rezolutave, që mund të kenë kaluar në parlament dhe nuk kanë pasur asnjë akses, por thjesht kanë kaluar dhe i ka pluhurosur koha gjatë gjithë situatës.

Shumë faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Hyseni, fjala për ju.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Në gjykimin tim, ardhja e kësaj projektrezolutive është shumë e rëndësishme. Shpeshherë ne i marrim të mirëqena të drejtat e njeriut, por harrojmë se sa mund është dashur në dhjetëra, qindra vite për të arritur në këtë standard që kemi sot, por edhe sa punë duhet për të arritur në atë standard që ideatorët e mëdhenj, filozofët e mëdhenj i kanë konceptuar këto standarde për të qenë në shoqëritë më të përparura dhe që ne besojmë se jemi akoma larg këtyre standardeve. Natyrisht që në këtë luftë të madhe janë disa kalorës, janë disa institucione, janë disa profesione, janë disa grupe shoqërore, të cilat janë në vijën e parë të luftës për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, ku, nisur edhe nga aktet ndërkombëtare në këtë fushë, kërkojnë një mbrojtje të veçantë. Ardhja e kësaj projektrezolutive përbën një risi dhe një hap përpara edhe në Shqipëri.

Zoti kryetar, nga pikëpamja procedurale kam një vërejtje, pasi kjo projektrezolutë duhet të kishte kaluar më parë në Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kërkoj ndjesë, por këtu nuk më rezulton se ka kaluar, nuk ishte e shprehur as në relacion, prandaj thashë të ezaurohet në këtë nënkomision. Në qoftë se ka kaluar jam dakord, në të kundërt, sugjeroj që të shikohet dhe të vazhdohe me procedurën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kërkoj ndjesë për vërejtjen e dytë, por duhet shprehur në rezolutë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Unë kam vetëm një mendim të natyrës procedurale. Natyrisht që nuk mund të mos e vlerësoj iniciativën dhe punën e bërë nga hartuesit, frymën që na karakterizon të gjithëve për ta mbështetur, angazhimin dhe praninë e aktorëve që janë të pranishëm në komision, por është bërë një kërkesë dhe nuk kemi pse zvarritemi. Këtyre u duhet kohë ta shohin. Me sa duket puna paraprake për të dëgjuar këta aktorë nuk është bërë mirë, nuk janë

thirruar dhe nuk janë konsultuar, kështu që ia vlen të thirren, të merren mendimet e tyre, të vlerësohen dhe ta shtyjme këtë punë, në mënyrë që ta bëjmë siç duhet.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Braho!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Kjo që po diskutojmë ne sot nuk është kohë e humbur, sepse, në fund të fundit, po japim mendime dhe sugjerime dhe nuk ishte menduar që ta kalonim sot. Pra, do të thotë se të gjitha sugjerimet që bëjmë ne regjistrohen dhe ato që do të sjellin aktorët e nderuar që janë këtu bëjnë të mundur që, kur të vijë në komision drafti përfundimtar, të jetë i gjithëpërfshirë. Nuk ka asgjë të keqe nëse ne bëjmë një diskutim këtu dhe e lëmë të hapur, që, kur të vijë drafti përfundimtar, t'i pyesim nëse janë ose jo dakord me këtë draft.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, të nderuar kolegë dhe përfaqësues të institucioneve kushtetuese të shoqërisë civile!

Për transparencë, dua t'ju them se ky projekt është konsultuar për katër muaj me komisionerin europian, me komisionerin e Kombeve të Bashkuara, me të dërguarin special, ku kemi komente me shkrim të tyre.

Unë e thashë edhe në fillim, nisma është firmosur nga ana ime, por këtu është punuar në grup dhe ka pasur një komunikim. Këtu dua të falënderoj edhe një herë ish-Avokatin e Popullit, i cili ka qenë koordinator midis këtyre aktorëve dhe shumë komente në projektin që ne po diskutojmë sot kanë ardhur nga komisioneri special i Kombeve të Bashkuara për mbrojtësin e të drejtave të njeriut, si dhe nga kolegët tanë, që janë në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Europës. Deputetja Bushka drejton një nga nënkomsionet ligjore të Asamblesë Parlamentare, e cila ka shqyrtuar dhe ka dhënë kontribut të madh në këtë projekt.

Unë pajtohem me kërkesën e bërë, qoftë nga organizatat e shoqërisë civile dhe nga institucionet kushtetuese. Ky projekt ka tre muaj në faqen zyrtare të Kuvendit. Me këtë rast duhet të praktikojmë dhe të mësojmë se jo për çdo gjë relatori dhe komisioni duhet të dërgojnë *online* dhe të vënë në dijeni shoqërinë civile, sepse ne kemi programin dhe transparencë parlamentare. Kjo deklaratë ka që në muajin korrik në faqen e Kuvendit, është lancuar, është diskutuar dhe shumica e propozimeve janë tuajat, të bëra në forumin e mbajtur në datën 13 prill 2018. Megjithatë, unë sugjeroj që të ulemi dhe të punojmë bashkë për të parë çdo paragraf.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Dakord.

Në fakt, kjo projektrezolutë ishte programuar të votohet në seancën e ditës së enjte, sipas kalendarit të punimeve të Kuvendit, por, me sa duket, çështjet e mbrojtjes të të drejtave të njeriut janë shumë sensitive, ndaj nuk është vetëm detyrë e institucioneve apo organizatave të shoqërisë civile, por e të gjithë shoqërisë, për shkak edhe të dimensionit që kanë të drejtat dhe liritë e njeriut.

Unë e kuptoj që projektrezoluta është punuar mirë nga nismëtarja, nga kolegja Hysi, nga Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut, edhe nga komunikimi që kam pasur me institucionet respektive europiane, por gjykoj që u duhet dhënë koha e nevojshme institucioneve tona, organizatave të shoqërisë civile, pse jo edhe aktorëve të tjerë që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, për ta pasuruar këtë projektrezolutë, sepse është ashtu siç tha edhe kolegu Fino, nuk duhet të jetë një projektrezolutë deklarative. Në sesionin që kaloi në Kuvendin e Shqipërisë kemi miratuar rezoluta për institucionet kushtetuese, kemi miratuar rezolutën për Avokatin e Popullit, për Komisionerin e Mbrojtjes nga Diskriminimi, pra kemi miratuar rreth 19 rezoluta në kuadrin e funksionit kontrollues që ushtron Komisioni i Ligjeve dhe nënkomisionet respektive të këtij komisioni. Këto rezoluta ne i kemi miratuar me afate, sepse në vitin pasardhës të raportimit, që do të kenë këto institucione në Komisionin e Ligjeve dhe në Kuvendin e Shqipërisë, do t'u kërkohet përmbushja e detyrave që janë lënë në rezoluta sipas afateve të përcaktuara. Prandaj mendoj se edhe kjo projektrezolutë do të duhet të ketë afate të qarta dhe një plan veprimi konkret. Nismëtares, relatores dhe të gjithë kolegëve të Komisionit të Ligjeve, që dëshirojnë të përfshihen në diskutim, për këtë projektrezolutë, do t'u japim kohën e nevojshme në dispozicion dhe do të jetë gati për seancën plenare të datës 20 shtator. Ne do të mbyllim miratimin e kësaj projektrezolute në Komisionin e Ligjeve të martën që vjen, prandaj sekretaria e Komisionit të Ligjeve, nismëtarja edhe relatorja, t'ua nisim edhe një herë këtë projektrezolutë të gjithë institucioneve që merren me mbrojtjen e lirive themelore të njeriut dhe të gjithave organizatave të shoqërisë civile. Pra, ditën e martë do të miratohet projektrezoluta, besoj se koha në dispozicion është e mjaftueshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nënkomisioni i të Drejtave të Njeriut do të bëjë punën e vet gjatë kësaj kohe, por ne mendojmë që seanca e datës 20 është mëse e mjaftueshme.

Fjalën e ka zonja avokate.

Erinda Ballanca – Për efekt të diskutimit, por edhe për çuarjen e punës përpara, po diskutoja me kolegët që të lëmë një takim parapërgatitor në institucionin e Avokatit të Popullit,

duke ftuar të gjithë aktorët e tjerë, ku t'i shikojmë këto ide dhe çështje në mënyrë të përmbledhur dhe të përbashkët, për të diskutuar në hapa më konkretë, sepse, për sa i përket mbështetjes politike është shumë në rregull. Nëse kjo çështje ka mbështetje politike, do të jetë shumë pozitive, por, nëse do të gjejmë hapa konkretë dhe mekanizma konkretë që të ndihet një rezultat në gjendjen dhe në cilësinë e mbrojtjes së të drejtave, këtu do të doja të kishim një diskutim të mëtejshëm. Prandaj duhet të kordinohemi që të bëjmë një takim paraprak që, kur të vijmë këtu, të kemi një diskutim më konkret dhe të jemi të gjithë në unison në lidhje me sugjerimet që mund të kemi.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Avokate!

Dakord, por do t'u lutesha Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut dhe relatores së kësaj projektrezolutive, zonjës Xhina, të koordinojnë këto takime, që në mbledhjet e ardhshme të Komisionit të Ligjeve të bëjmë një diskutim shterues lidhur me projektrezolutën dhe ta miratojmë për t'ia dërguar seancës plenare.

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Avokate e Popullit!

Kam një sugjerim, meqenëse kemi edhe rezoluta të miratuara për çështje specifike, siç është çështja e dhunës në familje, për LGBT-ën e të tjerë. Ne jemi përpjekur t'i shmangim rekomandimet konkrete, sepse me të drejtë është ajo që tha kolegu Fino dhe kryetari i komisionit, nuk duhet t'i mbivendosim. Unë jam dakord me propozimet shumë konstruktive të kolegut Fino, prandaj ejani dhe të vendosim disa afate, por pa bërë një vlerësim të situatës të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, do të ishte shumë e vështirë në këto momente. Prandaj, kur të diskutoni, ta shikoni edhe në këtë frymë. Është një ngarkesë e madhe pune, prandaj duhet të jemi realistë në afate dhe të bëjmë çdo gjë që është e mirë në kohë dhe me cilësi, pra të mos bëjmë një rezolutë thjesht për ta pasur.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Këtu u tha dhe është i qartë vullneti politik dhe mbështetja që ne si mazhorancë do t'i japim kësaj rezolutive, por edhe çështjes së mbrojtjes së drejtave dhe lirive themelore të njeriut, edhe mbrojtësve të këtyre të drejtave.

Këtu e mbyllim pikën e parë të rendit të ditës.

Faleminderit për pjesëmarrjen dhe një ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11 shtator 2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave”. (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Arben Pëllumbi dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Tom Doshi dhe Silva Caka.

Të ftuar:

Dorina Çinari – Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë
Agim Bregasi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Fatos Bundo – Drejtor në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare
Rolanda Hila – Specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Anisa Pine – Specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Aldo Xherahu – fotograf në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Tedi Bushaj – specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ulsi Manja – Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës. Pa humbur kohë, do t'ia jap fjalën zëvendësministres, zonjës Çinari, për të bërë një prezantim të kësaj marrëveshjeje për kolegët e komisionit, por edhe për opinionin publik dhe më pas fjalën e ka relatori Çuçi.

Mirëserdhët në komision!

Fjala është për ju.

Dorina Çinari – Faleminderit, zoti kryetar!

Mirëmëngjesi të gjithëve!

Projektligji që kemi sjellë është një draftmarrëveshje për shtesën e dytë të financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për akordimin e një financimi shtesë me vlerën 12 milionë euro për projektin e sigurisë së digave.

Objektivat kryesorë të projektit janë rritja e sigurisë së digave të hidrocentraleve më të mëdha në kaskadën e Drinit dhe rritja e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike si pasojë e përmirësimit të eficiencës së prodhimit. Programi u përgjigjet prioriteteve dhe qëllimeve të vendosura për zhvillimin ekonomik të vendit dhe, gjithashtu, është në përputhje me strategjinë kombëtare për zhvillimin dhe integrimin e Shqipërisë.

Hartimi i projektaktit zbatohet në nenet 81, pika 1, dhe 100 të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja e huasë është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me anë të vendimit nr. 303 të datës 25.05.2018 dhe është nënshkruar ndërmjet palëve. Është në përputhje me ligjin nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, e cila do t'i nënshtrohet procedurës së ratifikimit.

Teknikisht ajo çfarë do të ndodhë me shtesën e dytë të marrëveshjes, është faza e 5-të e programit për rehabilitimin e digave, që konsiston kryesisht në pjesët e mëposhtme: rehabilitimi i agregatit, turbinës nr. 4 dhe nr. 1 të Hecit Koman, rehabilitimi i portave të shkarkimit dhe remontit të Hecit Fierzë dhe Koman, ndjekja dhe supervizimi i aktiviteteve të cituara më lart nga konsulenti i implementimit dhe paneli i ekspertëve të projektit të sigurisë dhe digave.

Në mënyrë kompakte ky është prezantimi. Nëse ka pyetje teknike, jemi gati të përgjigjemi.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Fjalën e ka zoti Çuçi.

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Siç e tha edhe zonja zëvendësministre, kjo është një marrëveshje shumë e rëndësishme, sepse lidhet drejtpërdrejt me rritjen e sigurisë të digave në kaskadën e lumit Drin, që është burimi kryesor i energjisë për vendin tonë. Për një rifreskim për kolegët marrëveshja bazë ka dy aspekte: ka investimet në infrastrukturë për sigurinë e digave dhe asistencën teknike, trajnimin e personelit dhe punonjësve për sigurinë e digave. Të dy këta janë komponentë shumë të rëndësishëm, ndërsa shtesa që vjen tani lidhet me 2-3 gjëra specifike.

E para, ka të bëjë me kompletimin, furnizimin, instalimin dhe testimin e turbinave nr. 1 dhe nr. 4 të hidrocentralit të Komanit. Financimin e aktivitetit të konsulentit që do të merret me jetësimin e panelit të ekspertëve dhe me rolin e asistencës për njësinë e menaxhimit të projektit dhe supervizorin e kontraktorit, pra të asistencës teknike, si dhe financimin e të gjithë aktivitetit për rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe remontit të Fierzës dhe të Komanit. Pra, kjo është paketa që do të përfshihet me shtesën që ne do të miratojmë.

Nga pikëpamja ligjore dhe procedurale, si dhe nga mënyra e paraqitjes, është në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit.

Kështu që ftoj kolegët e komisionit ta miratojmë këtë marrëveshje.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Çuçi!

Ka pyetje nga kolegët? Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit!

Faleminderit që keni ardhur këtu sot!

Kam një pyetje. Zonja zëvendësministre, ju thatë se 12-milionëshi është i ndarë, siç tha edhe relatori, në instalimin dhe rehabilitimin e portave si ¼ e të tjera me radhë... Mund të jetë i detajuar ky 12-milionëshi, për të kuptuar më qartë sa para shkojnë për këto porta dhe sa shkon financimi i aktivitetit për konsulentin apo PMU-në dhe financimi i të gjitha aktiviteteve rehabilituese të jetë i ndarë? Domethënë, sa janë këto shifra, se nuk e kam të qartë?

Fatos Bungo – Faleminderit!

Në marrëveshjen e firmosur tashmë nga Ministria e Financave dhe Banka Botërore, këto shifra janë të detajuara, por mund t'ju informoj menjëherë.

Të tre komponentët që përmendi zoti Çuçi dhe zëvendësministrja, kanë të bëjnë me përfundimin e rehabilitimit të dy agregateve, turbina dhe Koman, të cilët do të kapin shumën 2,6 milionë euro. 2,6 milionë euro janë punime të parashikuara për rehabilitimin e turbinave, të cilat deri tani kanë kushtuar rreth 37 milionë euro dhe janë në financim e sipër. Ju duhet të

keni parasysh se turbinat janë një proces shumë delikat, pasi nuk mund të demontohen në mënyrë të menjëhershme të katra për të parë realisht defektet që janë në to.

Fatkeqësisht, deri më sot turbinat kanë punuar pa asnjë lloj sensori, sepse kemi një investim të realizuar nga viti '79 deri në vitin '83. Kanë qenë turbina që kanë punuar me sforco të madhe. Ka një kusht: 4 turbinat që ka Komani nuk mund të demontohen përnjëherë, por duhet të jenë 3 turbina në punë dhe 1 të demontohet dhe, hap pas hapi, mbasi demontohet njëra nga turbinat, shikohet realisht se çfarë defektesh suplementare ndodhin. Për dy turbinat e fundit, që janë në proces rehabilitimi në Koman, do të jetë e nevojshme një shtesë financimi prej 2,6 milionë eurosh, e cila është pjesë përbërëse e këtij 12-milionëshi. Sigurisht, pjesa e punimeve do të pasohet edhe me shtesën e supervizorit të punimeve dhe me 3 panelet e pavarura të ekspertëve, që asistojnë rehabilitimin e të gjitha projekteve të sigurisë së digave...

Bashkim Fino – Të të bëj edhe një pyetje, profesor? Dua të më detajosh 12-milionëshin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatos Bungo - 2,6 milionë euro janë 2 turbinat, turbina nr. 1 dhe turbina nr. 2. 1 milionë euro është vetëm supervizioni i punimeve dhe paneli i ekspertëve. Pjesa tjetër është për portat e shkarkimit në Koman dhe në Fierzë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatos Bungo – 2, 6 milionë janë turbina nr.1 dhe turbina nr. 4 në Koman. 1 milionë është supervizioni dhe paneli i ekspertëve, pjesa tjetër është rehabilitimi i portave të shkarkimit në Fierzë dhe në Koman.

Ulsi Manja – Diferenca.

Pra, nga 12 milionë, hiq këto dhe del diferenca.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Zonja Hysi ka pyetje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam një pyetje. Këshilli i Ministrave ka miratuar në prill të 2018-s vendimin nr. 197, i cili detyron propozuesit e projektligjeve për të pasur një vlerësim të ndikimit të mundshëm që mund të ketë një projektligj, një marrëveshje, në aspektin ekonomik, financiar, social dhe mjedisor. E kisha për zëvendësministren këtë pyetje. A është e mundur, që në projektligjet që sillni, kjo kërkesë e vendimit të Këshillit të Ministrave të reflektohet? E them këtë, sepse

Kuvendi ka një detyrim në kuadër të kontrollit parlamentar dhe të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, për të bërë një raportim vjetor se çfarë impakti kanë ligjet që miratohen.

Shumicën e rasteve, zoti Fino bën shumë pyetje të tilla, sepse e kemi shqetësim këtë. Ju mund ta keni si informacion, por në qoftë se nuk është këtu, qoftë për transparencë, por edhe për të na dhënë mundësinë më pas për të vlerësuar se si përdoren paratë hua (aq më tepër kur është hua) e vështirëson punën tonë. Prandaj, kam një sugjerim. Në radhë të parë, a është e mundur ta bëni, dhe e dyta, është e mundur ta kemi...?

Dorina Çinari – Atëherë, është e mundur ta bëjmë. Sot nuk e kemi me vete. Do t’jua sjellim me *e-mail*, nëse është e pranueshme për ju, pasdite ose nesër. Ky informacion është i përgatitur në kuadër të këtij projekti, por nuk e kemi me vete.

Ulsi Manja – Mund të na e dërgoni informacionin që keni në rrugë elektronike. E bashkëngjisim...

Po, zoti Bregasi...

Fatos Bungo – Mund të shtojmë diçka në përgjigje të pyetjes së zonjës Hysi.

Siç thuhet edhe në relacion, por edhe në kokën e projektligjit është “rehabilitimi”, pra ne po ndërhyjmë te hidrocentrali që është ndërtuar dhe është në shfrytëzim prej 30-40 vjetësh. Pra, turbinat dhe portat janë, vetëm po bëhet ndërhyrja për të rritur rendimentin e tyre dhe sigurinë e punës së tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shtesë financimi, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Fatos Bungo – Zoti Fino, thashë “përgjigja për zonjën Hysi”.

Pra, në projektligjin konkret nuk kemi të bëjmë me ndryshime të kushteve mjedisore apo...

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Bregasi!

Ju lutem...!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dorina Çinari – Në 2020-n.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Besoj se nuk ka pyetje të tjera nga kolegët.

Hedhim në votim në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave.”

Kush është dakord në parim?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1.

Kush është pro?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi këtë projektligj.

Kush është dakord në tërësi?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave.”

Ftoj relatorin, së bashku me relacionin, që në raportin që do të përgatitet për komisionin përgjegjës të shtojë të gjitha mendimet dhe sugjerimet që u dhanë nga kolegët dhe t’ia përcjellim komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare.

Këtu e mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Mbledhja e radhës do të jetë nesër. Rendi i ditës do t’ju njoftohet nëpërmjet postës elektronike nga sekretaria e Komisionit të Ligjeve.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

